



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:011736
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847920

KPPP.nr.1614/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “3P” SH.P.K., me NRB:71098621, me seli në Prishtinë Rr.”Ahmet Krasniqi”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Emin Zariqi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës- MPJD me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.549/21 të datës 13.12.2021 të Përmbartuesit Privat Sefer Sh. Arifi me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës- MPJD me seli në Prishtinë, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.549/21 të datës 13.12.2021 i Përmbartuesit Privat Sefer Sh. Arifi, për pjesën e detyrimit në shumën prej 54,356.50 €.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës- MPJD me seli në Prishtinë, ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.549/21 të datës 13.12.2021 i Përmbartuesit Privat Sefer Sh. Arifi, për pjesën e detyrimit në shumën prej 7,316.76 €.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “3P” SH.P.K., me NRB:71098621, ndaj debitorit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës- MPJD me seli në Prishtinë, sipas urdhrit P.nr.549/21 të datës 13.12.2021 i Përmbartuesit Privat Sefer SH. Arifi, për pjesën e detyrimit në shumën prej 54,356.50 €.

IV. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve të procedurës përbarimore për përpilimin e përgjigjes në prapësim të ia paguaj kreditorit shumën prej 208.00 € (dyqind e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.549/21 të datës 13.12.2021, me të cilin ka lejuar përbarimin, në bazë të dokumenteve të besueshme – Fatura me numër F21/019898 e datës 31.05.2021, fatura me numër F21/023182 e datës 30.06.2021, fatura me numër F21/024015 e datës 30.06.2021, fatura me numër F21/028208 e datës 30.07.2021, faturë me numër F21/027753 e datës 31.07.2021, fatura me numër F21/033125 e datës 31.08.2021, fatura me numër F21/033186 e datës 31.08.2021, fatura me numër F21/023182 ve datës 30.06.2021, fatura me numër INV/21/2076 e datës 10.09.2021, fatura me numër INV/21/8439 e datës 30.09.2021, fatura me numër INV/21/8536 e datës 13.10.2021, fatura me numër INV/21/8740 e datës 14.10.2021, fatura me numër INV/21/8737 e datës 14.10.2021, fatura me numër INV/21/10478 e datës 22.10.2021, fatura me numër INV/21/13628 e datës 31.10.2021 dhe fatura me numër INV/21/12801 e datës 03.11.2021, ku e ka urdhëruar debitorin t'ia paguaj borxhin e mbetur në shumë prej 61,673.26 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e arritjes së kërkesës për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Me njoftimin e Përbaruesit Privat të dorëzuar në gjykatë me datë 07.04.2022, ka njoftuar gjykatën se bazuar në listën e pagesave të dërguara nga kreditori, debitori ka bërë pagesën e pjesëshme të borxhit kryesor dhe atë në shumë prej 54,356.50 euro, dhe se borxhi i mbetur për pagesë është në shumë prej 7,316.76 euro si dhe kamata prej 8 % dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kundër urdhrin për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, ndër të tjerash ka theksuar se provat e paraqitura nuk kanë titull ekzekutiv sepse faturat e paraqitura nga kreditori nuk janë të nënshkruara nga debitori si dhe nuk ka prova se të njëjtat i janë dorëzuar debitorit. Ka shtuar se lejimi i përbarimit është bërë pa u plotësuar kushti ligjor në kuptim të dispozitave të LPP-së

për të qenë i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarim. I ka propozuar gjykatës që prapësimin ta aprovoj si të bazuar dhe urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjera ka theksuar se pretendimet e debitorit nga prapësimi i parashtruar kundër urdhrin përmbarimor janë të paqëndrueshme dhe nuk mbështetën në asnjë provë, sepse është bërë me qëllim të shtyrjes së pagesës meqenëse pezullon efektin juridik të urdhrin përmbarimor. Ka shtuar se kreditori gjithnjë në mbështetje të planit për menaxhimin e kontratës i ka dorëzuar faturat debitorit në fillim të muajit për muajin paraprak, të njëjtat nuk janë anuluar, ndryshuar apo shfuqizuar, por të njëjtat janë pranuar nga debitori pa ndonjë vërejtje. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet dhe urdhri përmbarimor të vërtetohet, si dhe të detyrohet debitori ti paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në padi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarim dhe i lejuar me urdhrin e përmbaruesit privat është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit në shumë prej 54,356.50 euro, për faturën me numër F21/019898 e datës 31.05.2021, faturën me numër F21/023182 e datës 30.06.2021, faturën me numër F21/024015 e datës 30.06.2021, faturën me numër F21/028208 e datës 30.07.2021, faturën me numër F21/027753 e datës 31.07.2021, faturën me numër F21/033125 e datës 31.08.2021, faturën me numër F21/033186 e datës 31.08.2021, fatura me numër INV/21/8536 e datës 13.10.2021, fatura me numër INV/21/8740 e datës 14.10.2021, fatura me numër INV/21/8737 e datës 14.10.2021, fatura me numër INV/21/10478 e datës 22.10.2021, dhe fatura me numër INV/21/12801 e datës 03.11.2021, fakt ky që vërtetohet nga komunikimi përmes email-it të datës 04.04.2022 nga i autorizuari i kreditorit me përmbaruesin privat duke i bashkangjitur listën e faturave të paguara si dhe borxhin e mbetur për pagesë, i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Andaj Gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.8 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“kredia është shuar si rezultat i ndonjë fakti të shfaqur në kohën kur debitori me*

nuk ka mundur të paraqes faktin e tillë gjatë procedurës nga e cila ka derivuar vendimi, pas përmbylljes së një ujdje gjyqësore ose një ujdje administrative ose në ndonjë mënyrë tjetër;” aprovoi pjesërisht prapësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që kredia që rrjedh nga dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbarimor, është shuar pjesërisht përmes përmbushjes së pjesshme nga ana e debitorit në shumën prej 54,356.50 €.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.549/21 të datës 13.12.2021, për pjesën tjetër të detyrimit në shumë prej 7,316.76 €, për faktin se faturat e lartcekura i plotësojnë në tërësi kushtet për të qenë dokumente të besueshme si dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “.* Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar pjesërisht detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit si rrjedhojë e përmbushjes së pjesshme të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa për pjesën tjetër përtej shumës së përmbushjes së detyrimit, dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë

dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbauesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohej në tërësi.

Gjykata i vlerësoj pretendimet e tjera të palëve në këtë procedurë, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbauese prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbauesi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbauesi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitur në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbauese.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbauese, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 par.2 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 208.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 64 par.4, nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbauese, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1614/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Gent Beker

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.